REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 958/7 Prot. Vlorë më, 19.03.2025

VENDIM

Nr. 31, datë 19.03.2025

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT "OPERATOR TURISTIK"

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d, të Ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, pika 1, gërma dh, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë,Udhëzimit nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe proçedurat për hapjen , rioorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen dhe bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" si dhe referuar shkresës së Sektorit të Kurrikulave dhe Statistikave me nr. 951 datë 19.03.2025, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 19.03.2024,

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren e Programit të studimit "Operator Turistik" sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Fakulteti Ekonomisë dhe Zëvendësrektori Akademik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI - VLORË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI ''ISMAIL QEMALI'' VLORË
FAKULTETI I EKONOMISË
DEPARTAMENTI I BIZNESIT

Adresa /Adress: Sheshi Pavarësia, Skelë – Vlorë
Web-site: www.univlora.edu.al

Nr._____Prot.

Vlore më,____/_____/2025

RREGULLORJA E PROGRAMIT MËSIMOR TË STUDIMEVE JOUNIVERSITARE:

DIPLOMË PROFESIONALE "OPERATOR TURISTIK"

Kjo rregullore është hartuar në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe Statutin e Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës.

Neni 1
Emërtimi dhe statusi i programit

Ky program do të ofrohet nga **Departamenti i Biznesit**, i cili është një nga Departamentet më të konsoliduar të Universitetit "Ismail Qemali", i krijuar si pjesë e Fakultetit të Ekonomisë që prej themelimit të tij në vitin akademik 1994-1995, me vendim të Këshillit të Ministrave **Nr.105**, datë **28.02.1994**. Departamenti i Biznesit synon të ofrojë një formim të shkëlqyer akademik për të përgatitur profesionistët e ardhshëm të cilët do të kontribuojnë në zhvillimin rajonal dhe kombëtar të vendit. Programi mësimor Diplomë Profesionale "Operator Turistik" është një program i studimeve Jouniversitare, i ofruar nga Departamenti i Biznesit, Fakulteti i Ekonomisë në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë dhe është i organizuar në dy vite akademikë (4 semestra) dhe në përfundim të tij studentët grumbullojnë 120 ECTS dhe marrin Diplomën Profesionale: "Operator Turistik".

Neni 2
Objektivat formuese të programit të studimit Diplomë Profesionale "Operator Turistik"

Përmes bashkëpunimit me njësi të tjera të Universitetit tonë, organizata të ndryshme, Universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit, ne synojmë të përgatisim Operator Turistik, të aftë të zbatojnë dhe menaxhojnë proceset e prodhimit dhe ofrimit të produkteve dhe shërbimeve turistike dhe të kuptojnë standardet e cilësisë së shërbimeve turistike, në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tregut turistik kombëtar dhe ndërkombëtar.

Objektivat formuese të programit profesional "Operator Turistik":

- Të pajisë studentë me njohuritë, kuptimin dhe aftësitë e nevojshme për punësim të suksesshëm në industrinë e mikpritjes dhe turizmit.
- Të mundësojë përparimin në një diplomë të ciklit të parë ose kualifikimin e mëtejshëm profesional në Menaxhim Turizmi.
- Të zhvillojë aftësinë e individit në industrinë e mikpritjes dhe turizmit nëpërmjet përdorimit efektiv dhe kombinimit të njohurive dhe aftësive të fituara në pjesë të ndryshme të programit.
- Të zhvillojë një sërë aftësish dhe teknikash, cilësish personale dhe atributesh thelbësore për performancën e suksesshme në vendin e punës dhe në këtë mënyrë t'u mundësojë studentëve të japin një kontribut të menjëhershëm në punësim.
- Të ofrojë fleksibilitet, njohuri, aftësi dhe motivim si bazë për studimet e ardhshme dhe zhvillimin e karrierës në Mikpritje dhe Turizëm.

Ky program profesional do të përgatisë specialistë të aftë për të punuar në institucione kryesisht private si Hotele, Restorante, Agjensi turistike dhe udhëtimi, etj, në role të ndryshme profesionale. Përmes marrjes së një diplome profesionale në "Operator Turistik", studentëve ju krijohet mundësia të licensohen për të qenë sipërmarrës të suksesshëm në fushën e turizmit.

Ne ofrojmë për studentët tanë:

- Cilësi në mësimdhënie duke aplikuar forma bashkëkohore të mësimdhënies.
- Përgatitje të lartë profesionale.
- Zhvillimin e aktiviteteve kërkimore shkencore.
- Pjesëmarrje dhe përfaqësim dinjitoz në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Një staf plotësisht të kualifikuar, i cili prezantohet me:
    - Artikuj Shkencorë të botuar
    - Libra të botuar
    - Konferenca kombëtare e ndërkombëtare

Prioritet i departamentit tonë gjatë programit të studimit Diplomë Profesionale "Operator Turistik", është jo vetëm pajisja e studentëve me njohuritë e nevojshme shkencore e profesionale në fushën e turizmit, por mbi të gjitha të krijojë një figurë profesionale me shkallë të lartë profesionalizmi sipas kërkesave të tregut turistik vendas dhe të huaj, si dhe për të qenë konkurrues me tregjet ndërkombëtare turistike.

Institucioni u siguron studentëve një formim bazë cilësor për të siguruar bazat e të ardhmes së tyre nëpërmjet:

- Kontributit në mënyrë efektive në formulimin dhe zbërthimin e politikave arsimore dhe vizionin e Universitetit të Vlorës, miratimin e rregulloreve të Universitetit dhe ndërgjegjësimin e publikut të gjerë, duke reflektuar praktikat më të suksesshme kombëtare e ndërkombëtare.
- Kontributit në formulimin dhe miratimin e politikave dhe rregullave përkatëse për rritjen e rolit të institucioneve akademike, duke përfshirë këtu përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive në fushat që departamenti mbulon.
- Përpunimit të planeve mësimore (kurrikulat) sipas kërkesave të Deklaratës së Bolonjës dhe orientimit të programeve mësimore drejtë Institucioneve homologë perëndimorë.
- Kualifikimit të stafit akademik nëpërmjet specializimeve pasuniversitare dhe marrjes së titujve dhe gradave shkencore.
- Përmirësimit të materialeve didaktike në shërbim të mësimdhënies.
- Zhvillimit të laboratoreve mësimorë në nivelet bashkëkohore të mësimdhënies.

- Lidhjes me organizata dhe institucione të tjera që kanë qëllime të përafërta apo që ndihmojnë rehabilitimin e politikave rajonale arsimore, mjedisore, etj.
- Zgjerimit të informacionit mbi departamentin dhe marketimit të tij në zona të tjera të Shqipërisë.
- Forcimit të procedurave të pranimit të kandidatëve të rinj në stafin akademik të mësimdhënies, përmes kritereve të qarta të testimit.
- Përfshirjes së mendimit të studentëve për arritjen e objektivave të mësipërm.
- Evidentimit të drejtimeve të reja të ekonomisë së tregut për Rajonin e Vlorës dhe më gjerë.
- Përgatitjes së operatorëve turistikë të aftë për tregun e punës, bazuar në nevojat e këtij tregu dhe konkretisht: në industrinë turistike, agjensi udhëtimi dhe turizmi, institucione publike të lidhura drejtpërdrejtë ose tërthorazi me menaxhimin e sektorit të turizmit, etj.

Neni 3
Ngarkesa mësimore në orë sipas formave të mësimdhënies

Ndarja e orëve mësimore për hartimin e programit të Diplomës Profesionale **"Operator Turistik"**, është bërë duke u bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave të botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programit të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë".

Neni 4
Lista e disiplinave mësimore, të ndara në module dhe veprimtari të tjera formuese

Tabela 1 - Ndarja e disiplinave sipas tipit të veprimtarive formuese				
Lëndë të detyrueshme				
Disiplinat	Nr.	Kodi	Lënda	Kredite
Disiplina të formimit të përgjithshëm (16 kredite)	1.	TUR 150	Baza Turizmi	8
	2.	BIZ 130	Sjellje Organizative	8
Disiplina të formimit karakterizues (64 kredite)	3.	TUR 196	Destinacione turistike	6
	4.	TUR 191	Operacione në hoteleri dhe restoranteri	8
	5.	TUR 192	Operacionet e agjensive të udhëtimit	8
	6.	BIZ 277	Etika dhe komunikimi në turizëm	8
	7.	TUR 295	Organizim eventesh	8
	8.	TUR 296	Organizimi i Ndërmarrjeve Turistike	8
	9.	TUR 297	Praktikë profesionale 1	6
	10.	TUR 298	Praktikë profesionale 2	12
Disiplina e lëndëve integruese / ndërdisiplinore (16 kredite)	11.	MKT 240	Marketing i shërbimeve turistike	8
	12.	BIZ 150	Menaxhim Binesi	8
Disiplina të formimit plotësues (18 kredite)	13.	ENG 131/ ITA 131	Gjuhë Angleze/ Italisht 1	8
	14.	CSE 130	Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	6
	15.	TUR 294	Aplikacione IT në turizëm	4

Detyrime përmbledhëse (6 kredite)	**16.**	**TUR 299**	**Provim diplome**	**6**

Neni 5
Katalogu i moduleve të programit Diplomë Profesionale "Operator Turistik"

TUR 150 Baza Turizmi

Lënda trajton gjerësisht kuptimin e dukurisë turizëm, përkufizimet dhe llojet e tij, kuptimin e turizmit si sistem, faktorët e zhvillimit të turizmit dhe funksionet e tij, aspektet ekonomike dhe joekonomike të turizmit, modele të zhvillimit si dhe aspekte të së ardhmes dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

BIZ 150 Menaxhim Biznesi

Lënda ka si objektiv të pajisë studentët me njohuritë bazë më bashkëkohore në fushën e menaxhimit të organizatave private dhe publike, duke trajtuar njohuri të domosdoshme mbi konceptin e menaxhimit dhe rolin e tij në shoqëri, paraqitjen e sfondit historik të zhvillimit të shkencave menaxheriale, identifikimin dhe sqarimin e funksioneve bazë menaxheriale (planifikim, organizim, udhëheqje & motivim, kontroll).

ENG 131 Gjuhë Angleze

Lënda ka si objektiv ofrimin e njohurive dhe shprehive të domosdoshme gjuhësore, komunikuese dhe funksionale në gjuhën angleze për të formuar specialistë në fushën e turizmit, të pajisur me njohuri gjuhësore praktike e teorike të mirëfillta e të plota rreth kontekstit turistik, historik e kulturor. Ajo synon përgatitjen e specialistëve të aftë të kryejnë detyrat, si të punësuar apo të vetëpunësuar për të ofruar shërbime si operator turistik, të pajisur me njohuri e etikë profesionale, shprehi të mira gjuhësore në gjuhën angleze, kompetencë ndërkulturore dhe aftësi të larta komunikuese, për ofrimin e shërbimeve cilësore në strukturat turistike e akomoduese, në institucione publike dhe private.

ITA 131 Italisht

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është akumulimi sa më i gjithanshëm i njohurive në gjuhën italiane, si dhe aftësimi i studentëve për të folur dhe shkruar në mënyrë të qartë dhe bindëse në këtë gjuhë. Kjo arrihet nëpermjet shtjellimit të elementëve të leksikut dhe gramatikës italiane, e kombinuar kjo me ushtrime praktike përgjithësuese bazuar në katër aftësitë kryesore të gjuhës: të folurin, të dëgjuarin, të shkruarin dhe të lexuarin.

CST 130 Teknologji Informacioni dhe Komunikimi

Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) është një fushë e gjerë që përfshin përdorimin e teknologjisë për të komunikuar dhe përpunuar informacionin. Kjo lëndë i njeh studentët me konceptet dhe teknologjitë themelore në fushën e TIK-ut. Studentët do të mësojnë rreth sistemeve kompjuterike, operacioneve bazë, rrjeteve, teknologjive të internetit, përpunimit të të dhënave dhe sigurisë. Gjithashtu kjo lëndë përfshin dhe programet bazë të paketës MS Office (Word, PowerPoint, Excel dhe Access).

TUR 196 Destinacione Turistike

Lënda ofron një sintezë të studimit të destinacioneve turistike nga këndvështrime të ndryshme duke përdorur koncepte të shumta dhe një sërë qasjesh, duke rishikuar në mënyrë kritike një gamë të gjerë kërkimesh ndërkombëtare. Ajo fokusohet në trajtimin e dy argumentave kryesore: struktura hapësinore dhe struktura organizative e një destinacioni turistik, bazuar në shqyrtimin sistematik dhe kombinimin e këtyre dy temave në destinacione nga shkalla kombëtare në atë lokale.

TUR 191 Operacionet në hoteleri dhe restoranteri

Operacione front-office dhe mirëmbajtje (Modul 1)
Studentët në modulin e "Operacione front-office dhe mirëmbajtje" do të marrin njohuri bazë mbi tipologjitë e strukturave hoteliere dhe restoranteve, rëndësinë ekonomike të këtyre strukturave, operacionet në hoteleri, organizimin e departamenteve në hotel, rezervimet dhe menaxhimin e dhomave, menaxhimin e shërbimit të pastrimit dhe mirëmbajtjes, operacionet e departamentit të recepsionit dhe krijimin e përvojave të klientit.

Operacione ushqim dhe pije (Modul 2)
Studentët në këtë modul do të marrin njohuri bazë mbi operacionet në restorante, duke trajtuar llojet e restoranteve dhe shërbimeve ushqimore, organizimin e stafit në restorante, planifikimin e menusë dhe çmimit të produkteve, menaxhimin e furnizimeve dhe magazinimit, blerjen e produkteve ushqimore dhe pijeve, procedurat e blerjes, zgjedhjen e furnitorit, mënyrat e blerjes, blerjen e pijeve alkolike, si dhe magazinimin dhe rezervat ushqimore, ruajtjen dhe depozitimin e produkteve ushqimore dhe pijeve dhe inventarizimin e produkteve në magazinë.

TUR 192 Operacionet e Agjensive të udhëtimit

Guida turistike (Modul 1)
Studentët në modulin e "Guida Turistike" do të marrin njohuri bazë mbi rolin në rritje të guidave turistike si profesionistë të turizmit që i udhëheqin turistët dhe i ndihmojnë në informimin dhe interpretimin e atraksioneve që ata vizitojnë në hapësirat më interesante të destinacioneve në një kohë kur industria është bërë më dinamike dhe ka nevojë për interpretime të sakta, adekuate dhe me nuanca kulturore.

Organizimi i udhëtimeve turistike (Tarifa dhe Biletari) (Modul 2)
Studentët në këtë modul do të marrin njohuri bazë mbi aktivitetin e operatorëve kryesorë të industrisë turistike, etapat e formimit të paketës turistike, planifikimin, politikat e përcaktimit të çmimeve dhe shitjen e paketës turistike. Do të trajtohen gjithashtu kodet ndërkombëtare të linjave ajrore dhe të aeroporteve, llogaritja e tarifave dhe emetimi i biletarisë për transportin ajror, roli i kontrollit të trafikut ajror, plani i faturimit dhe shlyera e IATA-s, roli dhe funksionet e faturimit dhe plani i zgjidhjes, kushtet për llogaritjen e tarifës dhe rëndësia e aspekteve të ndryshme në prcaktimin e tarifave.

BIZ 130 Sjellje Organizative

Sjellja Organizative hulumton ndikimin që individët, grupet dhe struktura kanë në sjelljen brenda organizatave, me qëllim të zbatimit të njohurive të tilla drejt përmirësimit të efektivitetit të një organizate. Krijimi i një vizioni të integruar për organizatën dhe komponentët e saj, analizimi dhe kuptimi i lidhjeve, ngritja dhe përdorja e teorive për spjegimin dhe parashikimin e sjelljes së anëtarëve, grupeve si dhe reagimit të strukturave, janë mekanizmat dhe njohuritë me të cilat do të zgjerohet bagazhi i studentëve të cilët ndjekin këtë disiplinë.

TUR 295 Organizizm Eventesh

Lënda "Organizim Eventesh" i njeh studentët me parimet, proceset dhe praktikat e menaxhimit të ngjarjeve. Ky kurs u ofron studentëve njohuri themelore dhe aftësi praktike të nevojshme për organizimin e suksesshëm të ngjarjeve. Temat përfshijnë planifikimin e ngjarjeve, logjistikën, marketingun, buxhetimin, menaxhimin e rrezikut dhe vlerësimin. Studentët do të eksplorojnë gjithashtu rolin e teknologjisë, komunikimit, shqetësimeve ligjore dhe çështjeve etike në planifikimin e ngjarjeve. Aftësitë praktike dhe njohuritë e industrisë do të zhvillohen për të përgatitur studentët për menaxhimin e ngjarjeve të shkallëve dhe llojeve të ndryshme.

BIZ 277 Etika dhe komunikimi në turizëm

Lënda synon të pajisë studentët me njohuri dhe aftësi mbi rëndësinë e sjelljes etike dhe komunikimit efektiv në industrinë e turizmit. Ajo përqendrohet në standardet etike, kodet e sjelljes dhe rolin e komunikimit në ndërtimin e marrëdhënieve të suksesshme me klientët, partnerët dhe komunitetin. Ky kurs eksploron rolin kritik të etikës dhe komunikimit efektiv në industrinë e turizmit. Studentët do të mësojnë të drejtojnë sfidat etike me të cilat përballen profesionistët e turizmit, të zhvillojnë strategji komunikimi për aktorë të ndryshëm dhe të analizojnë ndikimin e turizmit në komunitetet, mjediset dhe ekonomitë lokale.

MKT 240 Marketing i shërbimeve turistike

Kjo lëndë është një burim thelbësor për studentët dhe profesionistët e marketingut të shërbimeve. Ajo eksploron sfidat dhe strategjitë e marketingut në sektorin e shërbimeve, duke integruar teori dhe praktika moderne. Gjithashtu, ajo thekson rëndësinë e cilësisë së

shërbimit, menaxhimit të pritshmërive të klientëve dhe ndërtimit të marrëdhënieve të qëndrueshme me konsumatorët.

Përmes shembujve praktikë dhe rasteve të studimeve nga industria turistike, lënda ndihmon të kuptohet kompleksiteti i shërbimeve dhe të zhvillohen strategji efektive për të rritur kënaqësinë dhe besnikërinë e klientëve.

TUR 294 Aplikacione IT në turizëm

Lënda trajton njohuri për sistemet e informacionit në bizneset në fushën e turizmit, vecanërisht në njësite hoteliere. Studentët do të marrin njohuri për aplikacione IT në fushën e turizmit duke i ndihmuar në raportime si edhe në marrjen e vendimeve duke ndikuar në krijimin e avantazheve konkurruese. Krijimi i planeve të biznesit, kontabiliteti për njësitë turistike, përdorimi power Bi janë sfida aktuale me të cilat përballen profesionistët e njësive turistike.

TUR 296 Organizimi i ndërmarrjeve turistike

Lënda ka si objektiv njohjen e aktivitetit dhe organizimit të ndërmarrjeve turistike. Ajo ofron njohuri mbi konceptin e ndërmarrjeve pritëse, funksionet e tyre, karakteristikat themelore të ndërmarrjeve turistike pritëse, format dhe dimensionet e ndërmarrjeve turistike, klasifikimet e ndërmarrjeve pritëse të strehim-akomodimit, fushën e aktivitetit të ndërmarrjeve pritëse, klasifikimin tipologjik të strukturave pritëse hoteliere, llojet e tjera të klasifikimit të ndërmarrjeve pritëse dhe përshkrimin e zonave operative dhe impianteve te tij.

TUR 297 Praktikë profesionale 1

Nëpërmjet Praktikës profesionale 1, studenti do të zhvillojë aftësi praktike në lidhje me tematikat e ndryshme të trajtuara në kurrikulat e këtij program studimi. Në fund të Praktikës profesionale 1, studentët do të jenë të aftë të njohin aktivitetet dhe organizimin e ndërmarrjeve turistike që operojnë në qytetin e Vlorës, mënyrën e organizimit të tyre, si dhe aftësitë profesionale që ata duhet të zotërojnë për të punuar si operatorë turistik në industrinë e Mikpritjes dhe Turizmit.

TUR 298 Praktikë profesionale 2

Objektivi i Praktikës profesionale 2 është përgatitja dhe aftësimi i studentëve për një karrierë të suksesshme në të gjithë sektorët e ndryshëm të industrisë së udhëtimit dhe turizmit, duke i kompletuar ata në përfundim të ciklit të studimit me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në grupin e profesioneve "Operator turistik", me kod 3335 referuar Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), e rishikuar, miratuar me VKM nr 514, dt. 20.09.2017. Programi ka për objektiv kryesor të përgatisë staf të nivelit operativ të sektorit turistik me standarte të larta profesionale dhe etike, të aftë për të kryer aktivitete dhe operacione cilësore dhe në përputhje me kërkesat e tregut turistik ndërkombëtar.

TUR 299 Provim diplome

Për të përmbyllur studimet në diplomën profesionale "Operator Turistik" me 120 ECTS, studentët duhet të japin provimin e diplomës ku do t`i nënshtrohen një testimi me shkrim ose me gojë dhe do të vlerësohen nga anëtarët e komisionit AD-HOC të diplomimit të ngritur pranë Departamentit të Biznesit.

Neni 6
Kreditet dhe detyrimet penguese për çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese

Sipas rregullores së Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë studentët që ndjekin programin mësimor Diplomë Profesionale "Operator Turistik" mund të rregjistrohen në lëndët e vitit të dytë të këtij Programi Studimi vetëm pasi të kenë marrë paraprakisht 30 ECTS në përfundim të vitit të parë.

Neni 7
Kurrikulat e ofruara për studentët

Kurrikulat e moduleve të ofruara për studentët nga Departamenti i Biznesit janë paraqitur në syllabyset përkatëse të çdo lënde dhe shpallen në fillim të semestrit nga pedagogu përkatës. Programi i plotë i kurrikulave mësimore të ofruara për studentët e Departamentit të Biznesit për programin Diplomë Profesionale "Operator Turistik" mund të tërhiqet tek Zyra e Rregjistrimit të UV, pas pagesës përkatëse.

Neni 8
Format dhe organizimi i studimit të programit Diplomë Profesionale "Operator Turistik"

Në programin mësimor Diplomë Profesionale "Operator Turistik" veprimtaritë formuese që karakterizojnë programin e studimit ndahen në: mësim në auditor (leksione, ushtrime, seminare, laboratore), studim individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje provimesh, përgatitje për provimin final, etj). Leksionet, seminaret dhe laboratoret zhvillohen në ambientet e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Grupet mësimore të këtij programi organizohen si më poshtë: (VKM Nr. 41datë 24.01.2018 "Për elementet e programit të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë"):

Numri i studentëve në leksion	6 grupe seminare
Numri i studentëve në seminar	35 studentë
Numri i studentëve në laborator	25 studentë
Numri i studentëve në praktika	25 studentë

Neni 9
Format e provimeve dhe verifikimeve të tjera të dijeve të fituara nga studentët

Programi mësimor Diplomë Profesionale "Operator Turistik" parashikon në total 16 vlerësime përfundimtare të dijeve, duke përfshirë vlerësimet përfundimtare të lëndëve mësimore. Për lëndët që përmbajnë module vlerësimi bëhet në bazë të përqindjes së pikëve që studenti ka grumbulluar në vlerësimet e secilës prej moduleve dhe nxirret nota përfundimtare si rezultante e dy vlerësimeve. Format e kontrollit të dijeve përfshijnë detyrat e kursit, projektet, provimet e kursit, provimet e formimit.

Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për verifikimin e dijeve përdoren forma të ndryshme që kombinojnë verifikimin e vazhdueshëm (provimet e pjesshme, projektet/ detyrat e kursit) me atë përfundimtar (provimin final).

Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet:

a) me shkrim,

b) me gojë,

c) i kombinuar, me shkrim e me gojë duke u mbështetur në programin mësimor.

Vlerësimi përfundimtar i modulit bëhet minimalisht me një provim të pjesshëm dhe një provim përfundimtar, plus kërkesat specifike që vendos çdo pedagog për lëndën.

Tezat e provimit, në të gjitha rastet e kontrollit, hartohen nga titullari i lëndës. Kompromentimi i tezës është përgjegjësi direkte e pedagogut.

Në përfundim të programit të studimit studentit i njehsohet Nota Mesatare e Ponderuar, që merr në konsideratë edhe kreditet respektive për çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese.

Neni 10
Kushtet për t`u konsideruar kalues në një lëndë

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash, 1, ... , 10. Notat nga pesë e lartë janë kaluese. Në format e kontrollit me shkrim (provime, detyra/ projekte kursi) përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, konvertohet në notë. Në vlerësimin final të lëndës pedagogu përkatës përcakton edhe peshën e vlerësimit të punës së pavarur të studentit (detyrave/ projekteve të kursit).

Normat e konvertimit në notë të pikëve të grumbulluara përcaktohen nga pedagogët përkatës në çdo syllabus, por minimumi i përqindjes së pikëve të grumbulluara për marrjen e një vlerësimi pozitiv (me notë 5) është $\geq 40\%$ në të gjitha lëndët. Ulja e këtij kufiri mund të bëhet pas daljes së rezultateve të të gjithë grupit, me propozim të pedagogut të lëndës dhe miratim të përgjegjësit të Departamentit të Biznesit.

Për modulet e integruara (që përmbajnë më shumë se një lëndë) bëhet vlerësimi kolegjial i studentit në bazë të shumës së përqindjes së pikëve që ai ka grumbulluar në vlerësimet e secilës prej lëndëve përbërëse të modulit. Për të marrë një vlerësim pozitiv përfundimtar, studenti duhet të ketë grumbulluar $\geq 40\%$ jo vetëm të totalit të modulit, por edhe të pikëve përkatëse të çdo lënde përbërëse të modulit të integruar.

Neni 11
Procedurat e testimit dhe apelimit të rezultateve të testimit nga ana e studentëve

Procedura e kontrollit të dijeve është si më poshtë:
1. Në bazë të rregullores së UV, kontrolli i njohurive në programet mësimore të FE bëhet me një provim paraprak dhe një provim final, si dhe me anë të detyrave të kursit apo skedave të vlerësimit në laboratore dhe praktika mësimore.
2. Pas 48 orësh brenda kryerjes së kontrollit të njohurive (me gojë ose me shkrim) pedagogu njofton studentët për rezultatin e vlerësimit në provim.
3. Studenti ka të drejtë të shikojë fletën e tij të provimit individualisht.
4. Në qoftë se është i paqartë ose nuk është dakord me vlerësimin që ka marrë, ka të drejtë të kërkojë sqarime nga pedagogu përkatës.
5. Në qoftë se studenti është i paqartë ose nuk bindet për rezultatin e provimit paraqet një kërkesë me shkrim pranë sekretarisë së departamentit.
6. Në bazë të kësaj kërkese departamenti ngre një komision apelimi AD-HOC për vlerësimin e kërkesës së studentit. Komisioni duhet të bëjë rivlerësimin e provimit të studentit dhe duhet të japë përgjigje brenda tre ditëve nga momenti i paraqitjes së kërkesës për rivlerësim.
7. Pikët përfundimtare të testimit janë ato të vendosura nga komisioni i apelimit.

Neni 12
Rikontrollimi i dijeve të fituara

Studentët që kanë ndërprerë përkohësisht studimet duhet t`u nënshtrohen kontrolleve për verifikimin dhe vlerësimin periodik të krediteve të fituara, kontrolle këto për të garantuar mosvjetërimin e dijeve dhe përditësimin e tyre për kreditet e fituara më parë.
Edhe studentëve që u kanë zgjatur studimet më shumë se dy vjet përtej kohës normale të fitimit të Diplomës Profesionale "Operator Turistik", para dhënies së provimit final iu kontrollohen kreditet e fituara.

Neni 13
Orari i studimit dhe provimeve

Koha dhe auditori i zhvillimit të mësimit përcaktohet në orarin e shpallur nga Departamenti i Biznesit. Orari duhet të respektohet plotësisht nga të gjithë studentët dhe mësimdhënësit e Universitetit. Orari i përgjithshëm i Universitetit duhet të shpallet të paktën 3 javë përpara fillimit të semestrit. Orari i provimeve finale duhet të shpallet jo më vonë se 3 javë pas përfundimit të semestrit. Orari hartohet nga Departamenti i Biznesit dhe miratohet nga zëvendës-dekani i FE dhe zëvendës-rektori akademik i UV. Orari duhet të jetë i detajuar me sallat përkatëse dhe mund të ndryshojë vetëm me miratimin e zëvendës-rektorit akademik ose rektorit të UV.

Neni 14
Detyrimet e mundshme, që lidhen me frekuentimin

Frekuentimi i leksioneve është i detyrueshëm në masën 80%.
Frekuentimi i seminareve është i detyrueshëm në masën 80%.
Frekuentimi i laboratorëve është i detyrueshëm në masën 100%. Nëse, për arsye objektive, do të ketë mungesa në orë të veçanta laboratorike, do të gjendet koha e përshtatshme për zëvendësimin e tyre.

Neni 15
Karakteristikat e Detyrave/ Projekteve të kursit

Detyrat dhe projektet e kursit në programin Diplomë Profesionale "Operator Turistik" do të jenë dy tipesh: individuale apo në grup.

Neni 16
Provimi Përfundimtar

Në fund të programit të studimit, në kurrikul është parashikuar një Provim Përfundimtar i cili konsiston në një kontroll final të njohurive të përfituara nga studenti gjatë periudhës 2-vjeçare të studimeve në programin e Diplomës Profesionale "Operator Turistik". Para zhvillimit të provimit final, studenti do të marrë një program orientues në lidhje me lëndët dhe kapitujt që do të testohen në këtë provim.

Neni 17
Modalitetet për dhënien e diplomës në programin Diplomë Profesionale "Operator Turistik"

Në përfundim të kursit të plotë të studimeve, studentët kanë të drejtë të diplomohen. Kërkesat për fitimin e diplomës së ciklit të studimeve në programin Diplomë Profesionale "Operator Turistik", në Fakultetin e Ekonomisë - UV janë:
1. Studenti duhet të jetë vlerësuar pozitivisht në të gjitha modulet e detyrueshme në disiplinat: e formimit të përgjithshëm, karakterizuese, ndërdisiplinore, të lidhura me disiplinat karakterizuese, disiplinat me zgjedhje dhe për njohuri të tjera formuese (gjuhë e huaj) etj.
2. Studenti duhet të ketë vlerësim 'kalues' në Provimin Përfundimtar, sipas kërkesave të paraqitura në Nenin 17 të Rregullores së këtij programi mësimor.
3. Në përfundim të studimeve të ketë grumbulluar 120 ECTS (kredite).

Procedura e diplomimit
1. Studenti paraqet në Sekretarinë e Departamentit të Biznesit, Fakulteti i Ekonomisë kërkesën për diplomim, së bashku me gjeneralitetet personale.
2. Në bazë të kërkesës së studentit merret një kopje e listës së notave të studentit nga Zyra e Rregjistrimit të Unversitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

3. Komisioni i verifikimit të diplomave verifikon plotësimin e kritereve të diplomimit për **Diplomë Profesionale "Operator Turistik"**.
4. Nëse pas verifikimit konstatohet se studenti i ka plotësuar kriteret për t`u diplomuar, Departamenti i Biznesit, Fakulteti i Ekonomisë paraqet në Rektorat aprovimin e diplomimit të studentit në fjalë.
5. Pasi Rektori i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë aprovon kërkesën për diplomim Zyra e Rregjistrimit plotëson Diplomën dhe suplementin e Diplomës për çdo student.
6. Studenti merr formularin për marrjen e diplomës tek Zyra e Rregjistrimit dhe paraqitet në Bankë për të bërë pagesën.
7. Pasi bën pagesën, me faturën e bankës tërheq Diplomën tek Zyra e Rregjistrimit.
8. Nëse studentit i nevojitet program, merr formularin për program tek Zyra e Rregjistrimit, bën pagesën tek Banka, më pas tërheq programin e firmosur nga Zv.Rektori dhe të vulosur tek Zyra e Rregjistrimit.

Neni 18
Shkeljet e rregullave të fakultetit

Shkelje të rregullave të FE konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit që cënojnë personalitetin e mësimdhënies dhe të çdo punonjësi tjetër të shkollës, normat etiko-morale të shoqërisë si kopjimi në provime, falsifikimi i dokumentave të ndryshme, aktet e rrugaçërisë, të vjedhjes, etj, kur këto veprime nuk bartin elementë të veprës penale.
Ndaj studentit që kryen këto veprime, merren këto masa disiplinore:
- vërejtje me shkrim;
- përjashtim nga shkolla për një vit;
- përjashtim nga Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës;
- përjashtim përgjithmonë nga Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës.

Vendimin për përjashtimin e studentit një vit nga shkolla e merr Dekanati i Fakultetit të Ekonomisë.
Vendimin për përjashtimin nga Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës (heqje vetëm e së drejtës së studimit të filluar) dhe përjashtimin përgjithmonë nga Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës (duke mos i lejuar të fitojë të drejta studimi të mëpasshme) e merr Rektorati i Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës, mbi bazën e propozimit të Dekanatit.

Neni 19
Shkeljet e integritetit akademik

Të gjithë anëtarët e komunitetit akademik në Fakultetin e Ekonomisë - UV duhet të praktikojnë dhe të ruajnë standardet e integritetit akademik dhe ndershmërisë. Integritet akademik do të thotë të paraqesësh vetveten dhe punën tënde me ndershmëri. Prezantimi i keq i vetvetes dhe punës është mashtrim, sepse do të thotë që studentët pretendojnë kredite për ide apo punë që nuk janë në të vërtetë vepër e tyre dhe në këtë mënyrë kërkojnë një diplomë që në të vërtetë nuk është fituar.
Më poshtë janë disa shembuj pandershmërie akademike:

1. Mashtrim në provime. Këtu përfshihen të përdorësh materiale si libra dhe/ose shënime atëherë kur një gjë e tillë nuk është e autorizuar nga pedagogu, të kopjosh nga testimi apo detyra e dikujt tjetër, të ndihmosh dikë tjetër të kopjojë punën, të zëvendësosh punën e dikujt tjetër me punën tënde, të vjedhësh kopje të provimeve, ose të tjera forma shkeljesh në sjelljeje gjatë provimeve.
2. Plagjiaturë e punës së të tjerëve. Plagjiaturë do të thotë të përdorësh punën ose idetë e dikujt tjetër pa i dhënë atij personi kredit për punën e vet; duke bërë që këta studentë të pretendojnë kredit për mendimin e dikujt tjetër. Studentët duhet të dokumentojnë gjithmonë burimin e informacionit qoftë atëherë kur e kanë lexuar edhe atëherë kur e kanë dëgjuar. Kur punohet me burime të shkruara, një dallim i qartë duhet bërë midis thonjëzave (të cilat riprodhojnë informacionin fjalë për fjalë nga burimi dhe e vendosin atë midis thonjëzave) dhe perifrazimeve (të cilat e përpunojnë burimin e informacionit dhe e paraqesin atë me fjalët e studentit. Qoftë citimet midis thonjëzave, qoftë perifrazimet duhen të dokumentohen në çdo rast. Edhe në rastin kur studentët rishprehin, përmbledhin apo përzgjedhin pjesë nga puna e tjetrit, idetë i përkasin në çdo rast personit tjetër dhe mosdhënia kredit punës së tij përbën prezantim të keq të punës aktuale të studentit dhe plagjiaturë e ideve të dikujt tjetër. Të blesh një detyrë kursi ose të përdorësh informacion nga Rrjeti Ndërkombëtar i Informacionit ose Interneti pa njohur burimin dhe ta dorëzosh atë si punë vetjake është plagjiaturë.
3. Mashtrim në raporte laboratori duke falsifikuar të dhëna apo duke dorëzuar të dhëna të pabazuara në punën vetjake të studentit është shkelje.
4. Falsifikimi i dokumentave apo paraqitja dizinformuese e kredencialeve të një personi është shkelje.
5. Bashkëpunimi i paautorizuar në detyra kompjuterike dhe hyrje e paautorizuar dhe përdorimi i programeve kompjuterikë, duke përfshirë modifikimin e skedarëve kompjuterikë, të krijuar nga të tjerë dhe të paraqesësh atë punë si punën tënde është shkelje. Me përjashtim të rasteve kur japin udhëzime specifike, në të gjitha rastet pedagogët presin prej studentëve punë individuale pa ndihmën e të tjerëve në detyra kursi, provime, raporte laboratori dhe ushtrime kompjuterike, si dhe dokumentacion të të gjitha burimeve në rastet kur këto vihen në përdorim. Nëse pedagogët caktojnë një projekt të veçantë, përveç ose si shtesë ndaj provimeve, si për shembull detyrë kursi e bazuar në punë kërkimore, referatë e një libri, ata kanë përcaktuar që kjo punë është përmbushur vetëm për atë kurs. Studentët nuk duhet të dorëzojnë punën e kryer në një kurs që është marrë në të kaluarën apo për një kurs bashkëekzistues, përveç rasteve kur studenti ka leje të qartë për të bërë kështu nga të dy anëtarët e personelit akademik që janë pedagogë të kurseve.

Neni 20
Kushtet për procedurat e modalitetet për ndërprerjen e studimeve

Studenti mund të ndërpresë studimet në çdo kohë të vitit, për një afat jo më tepër se një vit dhe vetëm për këto raste:
Kur sëmuret për periudha të gjata, të dokumentuara me raport nga komisioni mjeko-ligjor, ku të jenë shprehur qartë diagnoza e rekomandimi. Dokumentat duhet të paraqiten përpara shkëputjes nga Universiteti, të shoqëruara me një kërkesë drejtuar Rektoratit.

Kur mbetet kryefamiljar, në raste fatkeqësish e në kushte ekonomike të vështira, të dokumentuara nga zyrat e Pushtetit Lokal. Këto dokumenta duhet të paraqiten përpara shkëputjes nga Universiteti, të shoqëruara me një kërkesë drejtuar Rektoratit.
Studentët, të cilët ndërpresin studimet për dy ose më shumë semestra rradhë, duhet të aplikojnë përsëri për pranim në Universitet. Vendimi merret nga një komision i ngritur nga Rektorati.

Neni 21
Kushtet për procedurat e modalitetet për transferimin e studentëve

Procedurat transferuese në Fakultetin e Ekonomisë përcaktohen në rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës. Procedurat transferuese përfundojnë përpara fillimit të semestrit.

Neni 22
Dispozita të veçanta

Departamenti i Biznesit dhe Dekanati i FE-së ka të drejtën dhe detyrimin e rishikimit periodik të kësaj rregulloreje, sidomos përsa i përket numrit të krediteve që i jepen çdo disipline të veçantë mësimore ose veprimtarie tjetër formuese.